



Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA) (Albanian)

Përfitimet

A kualifikohem për përfitime financiare përmes HASA-s?

Kriteret e kualifikimit: Për t'u kualifikuar për përfitime nga Ndhimja Ekonomike (CA), klientët duhet të përmbushin nivelin kualifikues të nevojës të shtetit të Nju-Jorkut. Për familjet me një pjesëtar, ne llogarisim fillimisht të gjitha të ardhurat, qiranë dhe suplementet nga HASA për të përcaktuar nëse klientit i mbeten më pak se \$376 në muaj (shuma ndryshon sipas madhësisë së familjes). Nëse klienti e përmbush nivelin e nevojës, ai kualifikohet për asistencë qiraje dhe ndoshta edhe për CA, nëse qiraja dhe kontrata e qirasë miratohen nga HASA.

Kufiri i të ardhurave: Të ardhurat totale të familjes duhet të jenë nën 200% të Nivelit Federal të Varfërisë (Federal Poverty Level, FPL), sipas madhësisë së familjes.

Kërkesa për të paguar 30% të të ardhurave të klientit për qira: Klientët që përmbushin kriteret e kualifikueshmërisë, që jetojnë në banesa private dhe që kanë lloje të tjera të ardhurash përveç CA-së, janë të detyruar të paguajnë 30% të të ardhurave bruto të familjes për qira. Të ardhurat e familjes llogariten përpara çdo të ardhure të përjashtuar. Qiraja dhe kontrata e qirasë së klientit duhet të miratohen gjithashtu nga HASA.

Çfarë janë të ardhurat e fituara të përjashtuara (Earned Income Disregard) dhe cilët klientë kualifikohen?

Të ardhurat e fituara të përjashtuara (Earned Income Disregard, EID) janë një masë për nxitjen e punësimit për marrësit e ndihmës ekonomike (Cash Assistance, CA), e cila redukton ndikimin e të ardhurave nga punësimi në përfitimet e tyre të CA-së. Ekzistojnë dy lloje të të ardhurave të fituara të përjashtuara. Lloji i parë është një përjashtim prej 100% i të ardhurave të fituara për një periudhë gjashtëmujore. Lloji i dytë është një përjashtim i vazhdueshëm prej 64% i të ardhurave të fituara.

EID-ja disponohet vetëm për klientët që marrin aktualisht CA dhe nuk aplikohet për programe të tjera të ndihmës që i përdorin të ardhurat si faktor për përcaktimin e kualifikueshmërisë (si p.sh. Programi i Ndhimës Ushqimore Suplementare [Supplemental Nutrition Assistance Program, SNAP]).

Të ardhurat e pafituara, si të ardhurat nga sigurimet shoqërore ose përfitimet e veteranëve, aktualisht nuk kualifikohen për përjashtime.

Pasi një familje përcaktohet si e kualifikuar për përfitime të vazhdueshme, ajo ka të drejtë të përfitojë përjashtim nga të ardhurat e fituara.

Shënim: Të ardhurat **NUK** përjashtohen gjatë përcaktimit fillestar të kualifikueshmërisë.

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Përfitimet (*vazhdim*)

Çfarë është një përjashtim prej 100% i të ardhurave të fituara për një periudhë gjashtëmujore?

Përjashtimi prej 100% i të ardhurave të fituara është një EID afatshkurtër që zgjat për një periudhë gjashtëmujore, e cila fillon menjëherë pasi klienti nis një punë të re me kohë të plotë ose të pjesshme. Në këtë rast, 100% e të ardhurave të klientit përjashtohen në rivlerësimin e kualifikueshmërisë për CA. Çdo pjesëtar i familjes kualifikohet vetëm një herë gjatë jetës për përjashtimin në masën 100% për një periudhë gjashtëmujore.

Pasi të dorëzoni fletëpagesat për 30 ditët e fundit, HASA do të përcaktojë kualifikueshmërinë tuaj.

Periudha gjashtëmujore është e pandërprerë dhe nuk mund të pezullohet. Pra, nëse një klient ndërpret marrëdhënien e punësimit gjatë kësaj kohe, periudha gjashtëmujore vazhdon të llogaritet. Megjithatë, nëse klienti gjen një punë të re brenda periudhës fillestare gjashtëmujore, të ardhurat nga puna e re mund të kualifikohen për përjashtim, me kusht që të ketë mbetur kohë nga periudha gjashtëmujore. **Shembull:** Një klient fillon një punë të re më 2 shtator 2025. Periudha gjashtëmujore e EID-së fillon më 2 shtator 2025 dhe përfundon më 1 shkurt 2026. Klienti e lë punën më 9 dhjetor 2025. Periudha gjashtëmujore e EID-së vazhdon të llogaritet. Klienti fillon një punë të re më 6 janar 2026. Nëse kualifikohet, të ardhurat e klientit do të përjashtohen për pjesën e mbetur të periudhës gjashtëmujore (deri në shkurt 2026).

Çfarë është EID-ja e vazhdueshme prej 64% dhe zbritja për shpenzimet e punës?

Sipas rastit, pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore të EID-së prej 100%, aplikohet EID-ja e vazhdueshme prej 64%. Përveç kësaj, dy herë në muaj zbatohet një Zbritje Standarde për Shpenzimet e Punës prej \$75. Zbritja Standarde për Shpenzimet e Punës aplikohet dy herë në muaj mbi të ardhurat që mbeten pas EID-së prej 64%.

★ Përqindja e të ardhurave të përjashtuara aktualisht është 64%, por mund të ndryshojë çdo vit më datë 1 qershor.

Si ndikon EID-ja në pjesën time të qirasë prej 30%?

Të ardhurat **NUK** përjashtohen kur llogaritet pjesa e qirasë prej 30% e klientit, përveçse kur klienti kualifikohet për EID prej 100%.

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Përfitimet (*vazhdim*)

Shembuj rastesh

Shembulli A: Aplikant pranë HASA-s që nuk ka të ardhura të asnjë lloji.

Aplikanti nuk ka asnjë të ardhur të fituar apo të pafituar.

Qiraja mujore = \$1,419

Aplikanti nuk ka asnjë të ardhur të fituar apo të pafituar.

Qiraja mujore = \$1,419

\$0 të ardhura – (\$1,419 qira + \$158.00 N&T + \$25.10 kredit për energjinë elektrike) =
-\$1,602.10 deficit

- Deficiti është më i ulët se niveli i nevojës prej \$376 i shtetit të Nju-Jorkut.

Aplikanti kualifikohet për ndihmë ekonomike dhe asistencë qiraje.

HASA i paguan qiradhënësit të gjithë shumën e qirasë prej \$1,419 pasi klienti nuk ka të ardhura.

Aplikanti merr një grant në para në dorë në vlerën \$376 për ushqim dhe për shpenzime të tjera pasi nuk ka të ardhura.

Shembulli B: E vetmja e ardhur e aplikantit janë të ardhurat nga sigurimet shoqërore, të cilat kanë vlerë më të ulët se qiraja e tij.

Të ardhurat e aplikantit nga sigurimet shoqërore (Social Security Income, SSI) = \$1,000

Qiraja mujore = \$1,419

\$1000 – (\$1,419 qira + \$158.00 N&T + \$25.10 kredit për energjinë elektrike)
= -\$602.10 deficit

- Deficiti është më i ulët se niveli i nevojës prej \$376 i shtetit të Nju-Jorkut.

Aplikanti kualifikohet për asistencë qiraje.

Pjesa e aplikantit për qiranë është 30% e të ardhurave: \$1,000 x 30% = \$300.00

HASA paguan drejtpërdrejt te qiradhënësi shumën e mbetur të qirasë në vlerën \$1,119.00.

Të ardhurat e mbetura pas pagesës së qirasë (\$1,000 – \$300 = \$700) janë mbi nivelin e nevojës prej \$376 të shtetit të Nju-Jorkut, kështu që aplikanti nuk merr grant në para në dorë.

Shembulli C: E vetmja e ardhur e aplikantit janë sigurimet shoqërore për personat me aftësi të kufizuara (Social Security Disability, SSD), të cilat janë më të larta se qiraja e tij.

Të ardhurat e aplikantit nga SSD = \$2,000

Qiraja mujore = \$1,419

\$2,000 – (\$1,419 qira + \$158.00 N&T + \$25.10 kredit për energjinë elektrike)
= \$397.90 tepicë

Teprica është më e lartë se niveli i nevojës prej \$376 i shtetit të Nju-Jorkut.

Aplikanti nuk kualifikohet për ndihmë ekonomike dhe asistencë qiraje.

Një përcaktim i veçantë do të bëhet për SNAP dhe Medicaid.

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Përfitimet (vazhdim)

Shembuj rastesh (vazhdim)

Shembulli D: Klienti HASA fillon një punë të re më 1 janar 2025 nga e cila fiton \$2,000 në muaj (bruto).

Klienti jeton në një banesë vetjake, me qira mujore = \$1,800

Të ardhurat vjetore bruto janë \$24,000, pra nën 200% të Nivelit Federal të Varfërisë (Federal Poverty Level, FPL) për familjet me një pjesëtar ($200\% \times \$15,650 \text{ FPL} = \$30,300$).

- Klienti kualifikohet për EID prej 100% për gjashtë muajt e parë të punës së re.

Për gjashtë muajt e parë:

- Të gjitha të ardhurat përjashtohen tërësisht gjatë përcaktimit të kualifikueshmërisë për përfitime nga CA-ja.
- $\$0 - (\$1,800 \text{ qira} + \$158.00 \text{ N\&T} + \$25.10 \text{ kredit për energjinë elektrike}) = -\$1,983.10 \text{ deficit}$
- HASA i paguan qiradhënësit të gjithë shumën e qirasë prej \$1,800 pasi klienti nuk ka të ardhura.
- Klienti kualifikohet për një grant në para në dorë në vlerën \$376, pasi vlerësohet me të ardhura \$0.

Pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore të EID-së prej 100%:

- $(\$2,000/\text{muaj} \times 64\% \text{ përjashtim}) = \$1,280$ përjashtohen, \$720 mbeten si të ardhura të reja.
- $\$720 - \$150 \text{ zbritje standarde mujore} = \570 të ardhura bruto të indeksuara (Adjusted Gross Income, AGI)
- $\$570 - (\$1,800 \text{ qira} + \$158.00 \text{ N\&T} + \$25.10 \text{ kredit për energjinë elektrike}) = -\$1,413.10 \text{ deficit}$
- Pjesa e klientit për qiranë është 30% e të ardhurave bruto:
 $\$2,000 \times 30\% = \600.00
- HASA paguan drejtpërdrejt te qiradhënësi shumën e mbetur të qirasë në vlerën \$1,400.00.
- Të ardhurat e mbetura pas pagesës së qirasë ($\$570 \text{ AGI} - \$600 = -\$30 \text{ deficit}$) janë mbi nivelin e nevojës (\$376) të shtetit të Nju-Jorkut, kështu që klienti kualifikohet për një grant në para në dorë në vlerën \$376.

Në të dyja rastet, do të bëhet një përcaktim i veçantë për SNAP dhe Medicaid.

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Përfitimet (vazhdim)

Shembuj rastesh (vazhdim)

Shembulli E: Klienti fillon një punë të re më 1 janar 2025, duke fituar çdo muaj të ardhura bruto në vlerën \$4,000.

Qiraja mujore = \$1,800

Të ardhurat vjetore bruto janë \$48,000 (\$4,000 x 12 muaj), pra mbi 200% të FPL-së për familjet me një pjesëtar (200% x \$15,060 FPL = \$30,120).

Klienti nuk kualifikohet për EID prej 100%.

Klienti mund të kualifikohet për EID prej 64%.

- $(\$4,000/\text{muaj} \times 64\% \text{ përjashtim}) = \$2,560$ përjashtohen, \$1,440 mbeten si të ardhura të reja.
- $\$1,440 - \150 zbritje standarde mujore = \$1,290 të ardhura bruto të indeksuara (AGI)
- $\$1,290 - (\$1,800 \text{ qira} + \$158.00 \text{ N\&T} + \$25.10 \text{ kredit për energjinë elektrike}) = -\693.10 deficit
- Pjesa e klientit për qiranë është 30% e të ardhurave bruto të tij: $\$4,000 \times 30\% = \$1,200.00$
- HASA paguan drejtpërdrejt te qiradhënësi shumën e mbetur të qirasë në vlerën \$600.00.
- Të ardhurat e mbetura pas pagesës së qirasë ($\$1,290 \text{ AGI} - \$600 = \$690$) janë mbi nivelin e nevojës (\$376) të shtetit të Nju-Jorkut, kështu që klienti nuk merr asnjë grant në para në dorë.

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Menaxhimi i rastit

A mund të marr me vete një avokat në takimin tim?

Po. Ju mund të merrni me vete një avokat ose përfaqësues në takimet tuaja. Avokati juaj duhet të identifikohet te stafi i recepcionit për të marrë një kartë si vizitor. Për më tepër, duhet të nënshkruani një formular publikimi HIPAA për të na lejuar që ta diskutojmë rastin tuaj me avokatin. Pasi të dorëzoni formularin e publikimit HIPAA dhe ta njoftoni agjencinë me shkrim që po i jepni leje avokatit për të kryer veprime lidhur me rastin në emrin tuaj, avokati do të mund të marrë informacion mbi rastin dhe dokumentacion nga regjistri i çështjes. Për më shumë informacion rreth mënyrës së plotësimit të HIPAA-s, referojuni Formularit të Autorizimit për Publikimin e Informacionit Shëndetësor dhe të Informacionit Konfidencial lidhur me HIV-in: **DOH-2557**.

Si mund ta mbyll rastin tim?

Nëse nuk dëshironi më të jeni pjesë e programit HASA, duhet të njoftoni punonjës të social personalisht ose përmes telefonit. Për të dokumentuar kërkesën tuaj, do t'ju kërkohej të plotësoni një formular të quajtur Deklaratë për Mospjesëmarrje.

A mund ta zgjedh vetë një punonjës social?

Punonjësve socialë u caktohen çështjet në bazë të një sistemi rotacioni. Megjithatë, klientët mund të lejohen që t'i ndryshojnë punonjës të socialë që u janë caktuar, me kërkesë dhe me një shkak të arsyeshëm, sipas diskrecionit të Drejtorit të Qendrës ose administratës së HASA-s.

Si mund të ndryshoj gjininë në kartën time CIBC?

- Ju lutemi, vini re se që nga data 30 prill 2015, Kartat e Identitetit të Përfitimeve të Përbashkëta të Shtetit të Nju-Jorkut (CBIC) nuk përfshijnë më një tregues të gjinisë.
- Për të ndryshuar gjininë tuaj në llogarinë tuaj Medicaid dhe/ose në regjistrin e çështjes suaj, duhet të na siguronit një nga dokumentet e mëposhtme ku konfirmohet gjinia juaj e re:
 - Certifikatë lindjeje/Certifikatë lindjeje e ndryshuar
 - Vendim gjykate (vetëm për ndryshimin e emrit)
 - Leje drejtimi nga shteti i Nju-Jorkut
 - Kartë identifikimi për jo drejtuesit, të lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut
 - Letër nga Administrata e Sigurimeve Shoqërore
 - Shënim mjekësor (vetëm për korrigjimin e gjinisë)
 - Certifikatë martese (vetëm për ndryshimin e emrit)
 - Pasaportë
- Hapi më i rëndësishëm është mbledhja e dokumentacionit. Pasi të marrim dokumentet e nevojshme, do të jemi në gjendje të bëjmë ndryshimin e kërkuar.
- Për më shumë informacion, referojuni dokumentit "Ndryshimi i emrit dhe gjinisë për klientët transgjorë dhe jobinarë". Pyetje të shpeshta (FAQ).

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Vizita në banesë

Sa shpesh kërkohen vizitat në banesë?

Shpeshësia e vizitave në banesë bazohet në nevojat individuale të një klienti dhe në llojin e banesës në të cilën jeton klienti. Më poshtë paraqiten kërkesat minimale për vizitat në banesë. Mund të planifikohen vizita shtesë, sipas nevojës:

- Në rastet e familjeve me fëmijë nën moshën 5 vjeçare, vizitat duhet të realizohen një herë në muaj.
- Në rastet e familjeve që jetojnë në banesat e jetesës së pavarur, ku nuk ka fëmijë nën moshën 5 vjeçare, vizitat duhet të realizohen çdo tre muaj.
- Klientët beqarë që banojnë në banesat e jetesës së pavarur duhet të vizitohen çdo tre muaj.
- Klientët e rritur beqarë që banojnë në strehim mbështetës (p.sh., strehim i përbashkët i përkohshëm, strehim i përbashkët i përhershëm, ose strehim në banesa të shpërndara) duhet të vizitohen çdo tre muaj.
- Të gjithë klientët që jetojnë në banesa të strehimit në raste urgjente duhet të vizitohen të paktën një herë në muaj derisa të sigurohet një banesë e përhershme.
- Një vizitë transferimi duhet të bëhet brenda shtatë ditëve të punës nga data kur rasti i është caktuar punonjësit të ri social.

Pse më duhet një vizitë në banesë?

Ligji vendor kërkon që klientëve të HASA-s t'u ofrohet menaxhim intensiv i rasteve dhe të mbahen në banesa të përshtatshme sipas gjendjes shëndetësore. Vizitat në banesë janë të nevojshme për t'u siguruar që klientëve të HASA-s dhe familjeve të tyre u ofrohen përfitimet dhe shërbimet e nevojshme për të garantuar shëndetin dhe sigurinë e tyre, si dhe që jetojnë në banesa të përshtatshme.

Po nëse nuk ndodhem në shtëpi për vizitën e planifikuar në banesë?

Nëse nuk do të jeni në shtëpi gjatë vizitës së planifikuar në banesë, duhet të njoftoni punonjësин tuaj social për të riplanifikuar vizitën. Mosrespektimi i vizitave të planifikuara në shtëpi mund të ketë një ndikim negativ në rastin tuaj.

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Strehimi

Cilat lloje strehimi/banesash janë të disponueshme?

- **Strehimi në raste urgjente:** Klientët e HASA-s, të cilat janë pranuar së fundmi si të pastrehë, mund të kërkojnë strehim ditor në Service Line, në adresën 400 8th Avenue në Manhattan. Klientët e tjerë që kanë nevojë për strehim në raste urgjente mund të vizitojnë punonjës të tyre social për të kërkuar strehim ditor. Strehimi në raste urgjente ofrohet vetëm përkohësisht. Në varësi të numrit të pjesëtarëve të familjes dhe disponueshmërisë së njësive, strehimi në raste urgjente përfshin caktimin në strehim mbështetës të përkohshëm, njësi banimi me një dhomë (njësitë SRO) ose apartamente familjare për raste urgjente.
 - **Strehimi mbështetës i përkohshëm:** Njësitë e strehimit të përkohshëm ofrojnë qëndrime afatshkurtra vetëm për individët e rritur beqarë. Dhomat private plotësisht të mobiluara janë të pajisura me tualete dhe dhoma ndenjeje personale ose të përbashkëta, si dhe përfshihen vakte në hapësira ngrënieje të përbashkëta dhe ambiente rekreative. Stafi i menaxhimit të rasteve në terren ofron akses në shërbimin e këshillimit për përdorimin e substancave dhe shëndetin mendor, si dhe asistencë në gjetjen e strehimit të përhershëm. Mund të ofrohen gjithashtu shërbime të tjera mbështetëse.
 - **SRO-të:** Njësitë SRO ofrojnë qëndrime afatshkurtra për individët e rritur beqarë dhe çiftet. Njësitë SRO janë dhoma private të mobiluara, me tualete personale ose të përbashkëta.
 - **Strehimi për familje në raste urgjente:** Familjet caktohen në apartamente private të mobiluara.
- **Strehimi mbështetës në raste jo urgjente:** Strehimi mbështetës është i disponueshëm për klientët që kanë nevojë për asistencë lidhur me pengesat që ua vështirësojnë jetesën e pavarur në komunitet. Disa modele të strehimit mbështetës ofrohen vetëm nëse klienti ka një historik të të qenit të pastrehë. Pas përfundimit të një aplikimi, klienti do të intervistohet nga një anëtar i Ekipit të Vlerësimit Shëndetësor Gjithëpërfshirës (Comprehensive Health Assessment Team, CHAT). Më pas, punonjësit socialë dhe specialistët e strehimit të HASA-s asistojnë klientët e kualifikuar për të identifikuar llojin e strehimit/banesës që u përshtatet nevojave të tyre individuale ose familjare. Klientët do të caktohen në bazë të përbërjes së familjes, nevojave të tyre individuale dhe disponueshmërisë.
 - **Banesat e përbashkëta:** Strehimi mbështetës i përbashkët ofron një sërë modelesh të banesave të mobiluara për individët dhe familjet, të gjitha në një çati të përbashkët. Disponohen shërbime sociale intensive në terren.
 - **Strehimi në banesa të shpërndara:** Programet e strehimit në banesa të shpërndara ofrojnë apartamente që merren me qira në emër të ofruesit të strehimit. Apartamentet mund të jenë të shpërndara në një lagje të caktuar ose në të gjithë qytetin. Këto programe përfshijnë shërbime mbështetëse të specializuara për individët e rritur beqarë dhe familjet.

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Strehimi (*vazhdim*)

Cilat lloje strehimi/banesash janë të disponueshme (*vazhdim*)?

- **Apartament privat:** HASA do të sigurojë asistencë qiraje për klientët e kualifikuar që dëshirojnë të banojnë në një apartament privat në komunitet. Klientët duhet ta kërkojnë vetë apartamentin. Punonjësit socialë mund të sigurojnë një listë të ndërmjetësve të apartamenteve që kanë asistuar klientët e HASA-s në të shkuarën. Megjithatë, ne nuk mund të garantojmë që këta ndërmjetës do të kenë apartamente të disponueshme në çdo kohë. Shikoni seksionin e pyetjeve të shpeshta te [Përfitimet](#) për më shumë informacion.

Njoftimi për të drejtat e qiramarrësit në strehim mbështetës

[Seksioni 21-149 i Kodit Administrativ të qytetit të Nju-Jorkut](#), i njohur gjithashtu si Ligji vendor 15 2022 (LL 15) u kërkon ofruesve të strehimit mbështetës, të cilët në disa raste quhen sponsorë të projektit dhe kanë kontratë me agjencitë e qytetit, si Administrata e Burimeve Njerëzore e qytetit të Nju-Jorkut (HRA), që të pajisin qiramarrësit në strehim mbështetës dhe qiramarrësit potencialë në strehim mbështetës, me një njoftim për të drejtat e qiramarrësit në disa raste të caktuara dhe me kërkesë. Ky ligj i ri hyri në fuqi më 9 maj 2022. Ky ligj nuk shton të drejta të reja, por informon qiramarrësit në strehim mbështetës dhe qiramarrësit potencialë në strehim mbështetës lidhur me të drejtat e tyre ekzistuese.

Ofruesit e strehimit mbështetës duhet të pajisin qiramarrësit potencialë dhe të përhershëm me këtë njoftim:

- Gjatë kohës së intervistimit
- Gjatë kohës së banimit fillestar në një njësi
- Në çdo rinovim të marrëveshjes së qirasë ose të programit
- Me kërkesë

[Njoftimi për të drejtat e qiramarrësit në strehim mbështetës \(PDF\)](#)

Gjuhë të tjera: [Español](#) | [Русский](#) | [繁體中文](#) | [简体中文](#) | [Kreyòl ayisyen](#) | [한국어](#) | [Italiano](#) | [Polski](#) | [العربية](#) | [Français](#) | [עברית](#) | [اردو](#)

Agjencitë e qytetit që administrojnë kontratat e strehimit mbështetës duhet të hetojnë ankesat që marrin në lidhje me mosdhënien e njoftimit nga ofruesi i strehimit kur i është kërkuar. Nëse një agjenci përcakton se një ankesë është e vlefshme (e justifikuar), agjencisë i kërkohet të lëshojë një fletëthirrje për ofruesin e strehimit për këtë shkelje të parashtruar në ankesën e vërtetuar ose të justifikuar, si dhe të postojë disa informacione në lidhje me ankesën në faqen e internetit të agjencisë.

Informacioni i postuar në lidhje me ankesën duhet të përfshijë:

- Identitetin e ofruesit të strehimit mbështetës
- Datën e dërgimit të ankesës
- Datën e përfundimit të hetimit për ankesën
- Rezultatet e ankesës
- Numrin dhe vlerën e penaliteteve të llogaritura

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Strehimi (*vazhdim*)

Njoftimi për të drejtat e qiramarrësit në strehim mbështetës (*vazhdim*)

Nëse ankesa vërtetohet, ofruesi i strehimit do të përballet me një penaltet civil prej \$250 për çdo fletëthirrje të lëshuar për çdo shkelje të parashtruar në një ankesë të justifikuar. Megjithatë, ofruesi i strehimit mbështetës mund ta shmangë përlogaritjen e penaltetit prej \$250 nga fletëthirrja ("korigjim") duke e pajisur qiramarrësin ose qiramarrësin potencial me njoftimin përkatës brenda 14 ditëve nga data e fletëthirrjes. Kini parasysh se, përveç pagesës së penaltetit prej \$250, pranimi i provave nga ana e agjencisë që çon në një "korigjim" mbetet një pranim i përgjegjesisë për të gjitha qëllimet dhe informacioni i lidhur me shkeljen e parashtruar në ankesën e justifikuar do të vazhdojë të publikohet në faqen e internetit të agjencisë.

Konfidencialiteti është shumë i rëndësishëm dhe identiteti i personit që regjistron ankesën nuk bëhet asnjëherë publik. Nëse po hasni vështirësi për të marrë një kopje të "Njoftimit për të drejtat e qiramarrësit në strehim mbështetës", të cilin ia keni kërkuar ofruesit tuaj të shërbimit të strehimit, kontaktoni punonjësin e rastit të HASA-s ose telefononi në numrin 311 për të bërë një ankesë.

Nëse dua të shpërngulem, a do të paguajë HASA për apartamentin tim të ri?

- Nëse aktualisht banoni në një apartament dhe dëshironi të shpërnguleni, mos e lini apartamentin tuaj aktual pa e diskutuar më parë me punonjësin tuaj social. Punonjësi i rastit do të punojë me ju për të përcaktuar llojin e strehimit që do të plotësojë më mirë nevojat e tua. Qëllimi ynë është që t'ju asistojmë që të mbani një strehim të qëndrueshëm, të përshtatshëm nga ana mjekësore dhe të përbalueshëm.
- Nëse jeni i pastrehë ose në rrezik të menjëhershëm (përballeni me një situatë të dokumentuar që përbën kërcënim për jetën ose me një rrezik ndaj shëndetit apo sigurisë), mund të caktoheni në një strehim të përkohshëm ndërkohë që kërkonit për një apartament të ri. Kontaktoni punonjësin tuaj social.

(Ktheni faqen)

Pyetje të shpeshta për Administratën e Shërbimeve të HIV/SIDA-s (HASA)

Strehimi (vazhdim)

Cilat janë udhëzimet për qiranë për strehimin e ri të pavarur?

Sipas udhëzimeve për qiranë, sasia e qirasë që HASA do të miratojë varet nga përbërja e familjes në rastin e HASA-s. Numri i dhomave të gjumit që do të miratohen varet nga numri i individëve në familje, marrëdhënia e tyre, mosha, gjinia dhe faktorë të tjerë. Udhëzimet për qiranë nuk ofrojnë garanci dhe janë subjekt i ndryshimeve.

Ky program i asistencës së qirasë i HRA-së nuk është një program i CityFHEPS ose një program i dhënies së kuponëve. Nëse apartamenti për të cilin një klient është i interesuar miratohet, HASA do t'ia paguajë qiranë drejtpërdrejt qiradhënësit ose administratorit të pronës. Nëse një klient ka të ardhura të tjera përveç ndihmës ekonomike, ka gjasa që klienti do të jetë përgjegjës për të paguar 30% të të ardhurave të tij për qiranë.

Qiraja duhet të përfshijë minimalisht ngrohjen dhe ujë dhe ujë të ngratë, me përjashtim të apartamenteve të përfuara përmes NYC Housing Connect dhe opsioneve të tjera si NYC Housing Lotteries. Gjithashtu, mund të jepen përjashtime të tjera në varësi të rastit. Miratimi do të varet, pjesërisht, nga një inspektim i apartamentit.

Shënim: Për rastet me rrethana lehtësuese të dokumentuara, madhësia e familjes së klientit është një nga disa faktorët që do të përcaktojnë qiranë maksimale të miratuar nga agjencia gjatë ushtrimit të diskrecionit të saj. *(p.sh. për të mbrojtur shëndetin ose sigurinë e klientit).*

Për udhëzimet për qiranë, në fuqi nga 10 shtatori 2025 deri më 31 mars 2026, referojuni [Udhëzimeve për Pagesën e Qirasë të Shërbimeve Speciale të HRA-së, në fuqi nga 9.10.2025](#). Për udhëzimet për qiranë, në fuqi nga 1 prilli 2026 dhe më vonë, shikoni [Udhëzimet për Pagesën e Qirasë të Shërbimeve Speciale të HRA-së](#).

A duhet ta inspektojë punonjësi i rastit një apartament të ri që dëshiroj të marr me qira?

Po. Pavarësisht nëse një njësi strehimi është inspektuar tashmë nga një subjekt tjetër, punonjësi i rastit tuaj duhet të kryejë inspektimin e tij përpara se banesa të miratohet për asistencë qiraje.

Si do të paguhet qiradhënësi im?

Nëse një individ kualifikohet dhe qiraja dhe kontrata e qirasë miratohen nga HASA, qiradhënësi, administratori i pronës ose agjenti i tyre do të marrë çeqe dy herë në muaj. Dy herë në muaj, qiradhënësi do të marrë një pagesë bazë për qiranë. Nëse klienti kualifikohet gjithashtu për subvencionin e qirasë së HASA-s, qiradhënësi do të marrë një pagesë tjetër shtesë nga HASA dy herë në muaj.